



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA DIBËR
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
P/ VENDIM

Nr. 04 date 11/07/2024

“Për një shtesë në vendimin nr.09 datë 31.01.2024 për miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit të destinuara për parkingjet e rezervuara në qytetin e Peshkopisë si dhe tarifave të shërbimit të arktimit të administruara nga Bashkia Diber”

Ne baze të vendimit Nr.09 Date 31/01/2024 në lidhje me miratimin e kriterëve të përcaktimit të zonave të administrimit të parkimit të destinuara për parkim në qytetin e Peshkopisë si dhe tarifave të shërbimit të arktimit të administruara nga Bashkia Diber si dhe në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 8, pika 2 e nenit 9, pika 1/1, shkronja b, nenit 9 pika 1/3, shkronja b, nenit 35, pika 5, shkronja a, nenit 54, shkronja f dhe nenit 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “ Per Veteqeverisjen Vendore”, nenit 7, pika 1 shkronjat e dhe f , pika 8, 10 e 11 të ligjit nr.8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë”, nenit 121 pika 1, 124 pika 1 dhe nenit 125 të ligjit nr. 8485 date 12.05.1999 “ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr. 129 date 12 /12 /2023. Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2024 Bashkia Diber.

KERKOJME:

1. Të miratojë kriteret për përcaktimin e zonave të administrimit për parkingjeve të rezervuara në Bashkinë Diber
2. Të miratojë zonat e administrimit të parkingjeve të rezervuara në qytetin e Peshkopisë.
3. Në mbështetje të pikës 1 ngarkohet Kryetari i Bashkisë Diber të vlerësojë plotësimin e kushteve për shtrirjen e zonave të administrimit të parkingjeve të rezervuara në Bashkinë e Dibres të ndjekë procedurat për plotësimin, permisimin ose shtimin e nënzonave të destinuara për parkim duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Shtojcën 1 dhe të propozojë keshillit bashkiak miratimin e tyre.
4. Të ndryshojë paketën e administruara nga Bashkia e Dibres sipas Shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtorinë e Shërbimeve Bashkiake.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Keshillit Bashkiak Diber dhe shprehjes për bazueshmeri ligjore nga institucionit të Prefektit të Qarkut Diber.

SHTOJCA NR.1

Kriteret per percaktimin e Zonave te Administrimit te Parkimit dhe nenzonat e tyre.

1. Zona e administrimit ne territorin e Bashkise Diber jane zona qe perfshihen ne sistemin e kontrolluar te administrimit te parkimit nga Bashkia Diber.
2. Zona te administrimit te parkimit konsiderohen zonat qe plotesojne kriteret sipas:
 - a) Percaktimeve te kodit rrugor dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij ku perfshihen te gjitha karakteristikat/ normat teknike dhe funksionale qe lidhen me percaktimin e parkimit dhe nderlidhjen me elementet e rruges ose jo.
 - b) Planit te Transportit ku perfshihen te gjitha elementet e planifikimit te transportit qe krijojne/ mundesojne realizimin e zonave/nenzonave te sherbimit te parkimit.
 - c) Planit te qarkullimit te mjeteve ku perfshihen te gjitha mundesit qe ofron plani i levizjes ne raport me karakteristikat/ normat teknike te percaktimit te vendeve te parkimit.
 - d) Kushteve te infrastruktes rrugore ku perfshihen e kushtet fizike te infrastruktures rrugore, e rikonstruktuar iose e pa rikonstruktuar dhe lidhja e saj me karakteristikat normat/ teknike te percaktimit te vendeve te parkimit.
 - e) Kategorizimeve te rrjetit rrugor dhe zonave jashte rruge sipas shkalles se intesitetit te aktivitetit social ekonomik:
 - I. Kategoria I- Rruge dhe zona jashte rruge qe vleresohen me aktivitet te dendur/ intesitet social ekonomik sidomos ne rruget me aktivitet tregtare sipas te dhenave te grumbulluara.
 - II. Kategoria II- Rruge dhe zonat jashte rruge qe vleresohen jo me aktivitet te dendur social dhe ekonomik dhe jo me aktivitet te dendur tregtar , por qe kane intesitet mesatar te fushave te mesiperme sipas te dhenave te grumbulluara
 - III. Kategoria III- Rruge dhe zonat jashte rruge qe vleresohen ose jo me aktivitet te dendur social dhe ekonomik dhe me aktivitet te vogel / ose fare tregtare sipas te dhenave te grumbulluara
 - f) Kriteri i kerkeses/ofertes: Disponibilitetin e hapsirave rrugore dhe zonave jashte rruge per vendparikme te ofertes dhe kerkeses per parkim sipas shkalles se zones ku ndodhet:
 - i) Kategoria I
 - b. Shkalla e zenies $> 110\%$ ne moemntet e jopikut
 - ii) Kategoria II
 - a. Shkalla e zenies deri ne 80% ne momentin e pikut
 - b. Shkalla e zenies deri ne 60% ne momentin e pikut
 - ii) Kategoria III
 - a. Shkalla e zenies deri ne 60% ne momentin e pikut
 - b. Shkalla e zenies 40% ne momentin e jopikut.
1. Zonat e administrimit te Parkimit (ZAP) detajohet ne nenzona. Detajimi indentifikohen zonat e destinuara per parkim-ne rruge dhe/ ose jashte rruge ne zonat (NDP) Nenzonat e Dedikuara ne Parkim.
2. NDP- te pa pagese ne rruge dhe/ose jashte rruge Brenda ZAP-ve perfshijne:
 - a. Parkim ne lagje.
 - b. Parkim i lire ose pa sistem kontrolli te kohezgjatjes se qendrimit prane stadiumit te Peshkopise (pa pagese).
 - c. Parkimi i rezervuar per automjetet e personave me aftesi te kufizuara pa pagese.
3. Kriteret per percaktimin e NDP pa pagese ne rruge dhe zonat jashte rruge brenda ZAP-ve

- a. Rezervimi i nje numri te caktuar vendesh parkimi per automjetet e personave me aftesi te kufizuar (PAK) dhe parkim te lire pa roja ose pa sistem (PL) ne masen jo me e vogel se 2% NDP.
- b. Rezervimi i nje numri te caktuar vendesh parkimi per automjetet e banoreve (A) ka si kriter vleresimi kriteret qe lidhen me kategorizimin e rrjetit rrugor dhe kerkeses/ ofertes ku nderthurja e kategorise 3 te rrjetit rrugor dhe kategorise 1.3 te kerkeses/ ofertes mundeson nje rezervim.
 - i) Deri 70% te NDP ne favor te (A)
 - ii) Deri ne 30% te NDP ne favor te (PL) dhe (PAK).
4. Vleresimi i NDP pa pagese ne raport % (perqindje) me NDP e parkimit me pagese varion/kryhet rast pas rasti sipas nderthurjes se treguesve te kategorizimit te rrjetit rrugor dhe kerkeses/ ofertes per cdo ZAP.
5. NDP me pagese ne rruge dhe/ose ne zonat jashte rruge Brenda ZAP-ve jane:
 - a. Vendparkim me pagese.
 - b. Vendparkim i rezervuar.
6. Kriteret per percaktimin e NDP me pagese ne rruge dhe/ ose jashte rruge Brenda ZAP-ve.
 - a. Rezervimi i nje numri te caktuara vendesh parkimi me pagese kur vleresimi sipas kriterëve NDP-se qe lidhen me kategorizimet e rrjetit rrugor dhe kategorizimet e kerkeses/ofertes krijon nderthurje te kategoris 1.1 te Rrjetit Rrugor dhe Kategorise 1.1 te kerkeses/ ofertes-mundeson nje rezervim nga 50% deri 100% te NDP-se ne favor te parkim me pagese.
 - b. Rezervimi i nje numri te caktuar vendesh parkimi te rezervuar me pagese dhe/ ose taksi behet me ne nje mase jo me te madhe se 20%-30% e NDP-se.
 - c. Vleresimi i NDP-ve me pagese ne raport % (perqindje) me NDP-te e parkimit pa pagese varion rast pas rasti sipas nderthurjes se treguesve te kategorizimit te rrjetit rrugor dhe kerkeses/ofertes per cdo NDP.
 - d. Ditet e sherbimit te parkimit me pagese dhe rruge dhe zonat jashte rruge jane nga e hena ne te shtunen.
 - e. Per rruget ose/dhe zonat jashte rruge qe vleresohen nga drejtoria perkatese se gjate fundjavave kane aktivitet intesiv social dhe ekonomik sistemi i kontrollit do te operoje nga e hena ne te shtunen (sidomos ne rrugete me aktivitet tregtar, te njohura si rruget/ zona tregtare).
 - f. Parkimi me pagese ne zonat e miratuara si te tilla do te shtrijne kohezgjatjen prej ores 8:00 deri ne oren 20:00 , zona e parkimit ne shesh do te alternohet sipas vendimit te keshillit bashkiak per qarkullimin e mjeteve ne kete zone.
 - g. Ne te gjitha zonat cdo kategori parkimi ne rruge pas ores 20:00 deri ne oren 08:00 eshte parkim i lire i pa rezervuar, pa pagese.
 - h. Ne zona te caktuara te sherbimit te parkimit pa pagese, vendoset kufizimi i kohezgjatjes se qendrimit me pagese 1 ore deri ne jo me shume se 4 ore ne te njejtin vend me pagese. Vendimi perkates merret nga Kryetari i Bashkise nese nje rruge ka kerkeses te larte per parkim, per shkak te vendodhjes afer:
 - a. zonave tregtare/ tregjeve,
 - b. zonave ku ofrohen sherbime te ndryshme publike dhe private.

- PARKINGJET E REZERVUARA

ZONA

Autovetura sipas intervalit te qendrimit	Tarifa/Leke/ne vit /365 dite
VENDPARKINGU I PARE	40 000
VENDPARKINGU I DYTE	60 000

Per 1 vendparking te rezervuar per nje periudhe 1 vjecare pagesa do jete 40 000 lek.

Per vendparkingun e dyte pagesa do jete 60 000 lek.

Drejtori Sherbimeve Drejtori Dpzht Drejtori Juridik Drejtori Ekonomi Kryetar

Bedri KAMBERI

Elvis MANGA

Ismet SARACI

Celjta ZUNA

Rahim SPAHICU



